



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Zyra e Auditorit Gjenera/Kancelarija Glavnog Revizora

AUDITIMI FINANCIAR
KOMUNA E GJAKOVËS
PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN QË PËRFUNDON MË
31 DHJETOR 2007

Prishtina, Dhjetor 2008

LETËR DORËZIMI

Datë: 26.12.2008

Për: Z. Pal Lekaj

I nderuar Z. Lekaj,

Ky është raporti ynë final mbi rezultatet e auditimit nga Zyra e Auditorit Gjeneral të pasqyrave financiare të Komunës së Gjakovës për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2007. Në pajtueshmëri me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/33, ky raport do të bëhet publik.

Raporti ynë përmban rekomandimet për veprimet tuaja. Rregullorja 2005/33, Neni 1 B. (e) kërkon që brenda 30 ditëve të publikimit të raportit tonë të auditimit, ju duhet të parashtroni një raport që tregon se si institucioni juaj do të implementoj këto rekomandime. Rapoti juaj pritet më 30 Janar 2009.

E vlersojmë bashkëpunimin dhe mirësjelljen e ofruar stafit tonë gjatë auditimit. Zyra e Auditorit Gjeneral mirëpret bashkëpunimin me ju në të ardhmen në auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2008.

Me nderime,

Linda Casella
Auditor Gjeneral

PËRMBAJTJA

I.	Përmbledhje e Përgjithshme	5
II.	Parathënie	6
III.	Statusi i Rekomandimeve të Auditorit nga Vitet e Mëhershme	7
IV.	Fushëveprimi i Auditimit	15
V.	Mendimi i auditorit	16
VI.	Çasja e Auditimit	18
VII.	Të Gjeturat Kyqe të Auditimit dhe Rekomandimet	20

Shtojcë

- I. Komuna e Gjakovës
Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2007
- II. Komentet e Menaxhmentit të Komunës

Lista e Shkurtesave dhe Akronimeve

AGJ	Auditori Gjeneral
UA	Udhëzimi Administrativ
OE	Operatori Ekonomik
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
MEF	Ministria për Ekonomi dhe Financa
MSHP	Ministria e Shërbimeve Publike
OAG	Zyra e Auditorit Gjeneral
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
SE	Sigurimi i Ekzekutimit
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

I. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Zyra e Auditorit Gjeneral ka kryer auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Gjakovës (më tej referuar si “Komuna”) për vitin e përfuduar më 31 Dhjetor 2007.

Për shkak të çështjeve të diskutuara në Pjesën V: Mendimi i auditorit ne nuk ishim në gjendje të japim dhe ne nuk japim një mendim mbi pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2007.

Të gjeturat dhe rekomandimet e ndërlidhura janë paraqitur përbrenda Pjesës VII të raportit. ZAGJ nxit Manaxhmentin e Lartë të Komunës të ndërmarrë veprime korrigjuese mbi këto rekomandime dhe para kësaj të paraqesë një Plan Veprimi për shqyrtimin e këtyre rekomandimeve 30 ditë nga pranimi i Raportit Final të Auditimit.

II. PARATHËNIE

Rregullorja e UNMIK-ut 2002/18, datë 4 Tetor 2002, ka themeluar Zyrën e Auditorit Gjeneral (ZAGJ) në Kosovë. Sipas Nenit 3.2 të kësaj rregullore, nga Auditori Gjeneral (AG) kërkohet të kryejë auditim për çdo vit të të gjitha institucioneve të Kosovës që të përcaktojnë:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pasqyrë të saktë dhe të drejtë;
- Nëse shënimet financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme;
- Përshtatshmërinë e kontrolleve të brendshme dhe funksioneve të auditimit të brendshëm;
- Ndërshmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative të ndërmarra përbrenda institucioneve apo entiteve të audituara; dhe
- Të gjitha çështjet që dalin ga auditimi ose që ndërlidhen me të.

Në Mars 2003, Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Ligjin Nr. 2003/2 “Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë” që është miratuar zyrtarisht nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) më 12 Maj 2003 me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/17. Neni 42 i Ligjit deklaron se AGJ do të përgatisë dhe t’i dorëzojë Kuvendit dhe PSSP-së një raport mbi deklaratat financiare të organizatave buxhetore për vitin e kaluar fiskal ku do të parashtrihen opinionet e AGJ mbi atë se nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në financat e organizatave buxhetore në fjalë.

III. STATUSI I REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT NGA VITET E MËHERSHME

Auditimi nga ZAGJ i pasqyrave financiare të Komunës për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2006 ka rezultuar në 25 rekomandime të auditorit (detajet e të cilave janë paraqitur në tabelën më poshtë). Auditimi ynë aktual ka përcaktuar se Komuna nuk i ka implementuar 7 rekomandime.

Nr	Të gjeturat	Rekomandimi	I implementuar Po/ Jo
2	Ne kemi vërejtur se komuna nuk ka bere harmonizimin e shënimeve të saja me shënime të thesarit (free - balancit).	ZRGJ-ja Rekomandon që aplikohet LMFPF qe ne të ardhmen të bëhet harmonizimi i shënimeve të komunës me ato të thesarit.	I implementuar
4	Sistemi i Kontrollit të Brendshëm		
	Sistemi i kontrollit të brendshëm nuk është efikas, pasi që komuna nuk ka qenë në gjendje që ti parandaloj gabimet dhe parregullsitë që janë bërë siç janë shkeljet e LPP, LMFPF dhe menaxhimin e pasurive	ZRGJ-ja Rekomandon që të aplikohen ligjet dhe rregulloret në fuqi qe do te rezultonte me përmirësim te sisteme te kontrollit të brendshëm e njëherazi edhe me menaxhim te mire te fondeve dhe pasurisë se komunes	I paimplementuar
4.1	Auditimi i Brendshëm si një segment me rendësi ne kuadër të kontrollit të brendshëm Entiteti ka njësinë e Auditimit të Brendshëm me një punonjës të auditimit i cili është edhe kryesues i njësisë. Auditori është economist por nuk është Auditori i Licencuar e as Kontabilistë i Certifikuar. Roli i NJAB është që të rishikoj procedurat dhe burimet e brendshme. Është vërejtur së entiteti nuk ka komitet të auditimit dhe në mungesë të këtij raporton tek menaxhmenti (komitetit per politik dhe financa). Bazuar në shqyrtimet tona kemi vërejtur se plani i auditimit të brendshëm per vitin 2006 nuk ka qenë i aprovuar nga krye-shefi. Auditori i Brendshëm ka përgatitur 5 raporte finale per drejtorit të ndryshme të komunës dhe një raport përmbledhës per periudhën janar dhjetor2006.	ZRGJ-ja Rekomandon që njësia e auditimit te brendshëm te ketë: - Trajnime te stafit per certifikim dhe licencim. -Te fokusohet në auditimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të entitetit. -Aprovuar planin e auditimit. -Rruajtura letrat e punese dhe raportet në forme elektronike, nese nuk ka siguri brenda objektit të Komunës atëherë raportet të ruhen në kopje rezerve (CD) jashtë objektit te Komunes.	I implementuar
5.1	Të Hyrat Vetjake Të hyrat nga arsimi joformal dhe nga konvikti per vitin 2006 kanë qenë 64,693€ të cilat nuk janë prezantuar në pasqyra financiare e as nuk janë dorëzuar në llogari të BKK-së. Gjithashtu kemi vërejtur se këto mjete jane shpenzuar per nevoja te shkollës dhe konviktit pa u raportuar fare ne komunë. Gjate testimit te faturave dhe kuponëve kemi vërejtur se kane parregullsi siçjane: Kuponi më vlerë 1,070€ nr. 036818 i dates 03.11.2006 nuk dihet në emër të kujt është lëshuar si dhe vlera per njësi me vlerën totale dhe sasinë e blerë nuk paraqet gjendjen e vërtet. Gjatë ekzaminimit fizik inventari i blerë në vlerë 1,070€ në SHMM "HYSNI ZAJMI" Gjakovë nuk është dëshmuar se ekziston në këtë shkollë.	ZRGJ-jaRekomandonKomunës që të aplikojë nenin 10 dhe 13 te Ligjit per Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë duke bere: - kontrollim , mbledhje dhe deponim te duhur te hyrave në llogarinë e BKK. Gjithashtu rekomadojm qe te gjitha te hyrat komunale te të përfshihen në Pasqyra Financiare dhe te gjitha blerjet duhet kane të bashkangjitur faturat se bashku me kuponë	I implementuar

Auditimi Financiar
Komuna e Gjakovës për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2007

5.1.1	<p>Të hyrat nga Tatimi në pronë Gjatë vitit 2006 janë lëshuar 20,472 fatura në vlerë prej 750,969 € ndërsa janë arkëtuar 8,511 fatura në vlerë prej 289,212€respektivisht 41.5%. Ne kemi vërejtur se llogaritja e kamatës për tatimin në pronë nuk është bërë për të gjithë tatimpaguesit në baza mujore si dhe kalkulimet e bëra nuk janë llogaritur në baza mujore dhe të sakta. Nga pasqyra e të hyrave të arkëtuara për vitin 2006 vërehet se ka diferenca në mes të shënimeve të marra nga komuna dhe free -balance të cilat diferenca janë paraqitur në tabelën nr 2.</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që të aplikohet "Rregullorja e UNMIK -ut 2003/29 e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/59 per Tatimin në Prone", dhe aplikimin e kamatave per vonesat e pagimit të tatimit në prone</p>	I implementuar
5.1.2	<p>Të hyrat nga Kadastra - Gjeodezia Në një mostër të marrë nga kjo drejtori kemi vërejtur se nuk është bërë pagesa per faturën nr. 2/2007 në vlerë prej 488€per kërkesën nr. 302/06 të dates 25.05.2006</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon të aplikohet rregullorja qe percakton dhe ngarkesat per sherbime kadastrave</p>	I implementuar
5.1.3	<p>Të hyrat nga shëndetësia Të hyrat nga participimet në shërbime shëndetësore per vitin 2006 janë 48,488€ Gjatë ekzaminimit ne kemi vërejtur se dëftesat nuk janë të nënshkruar dhe të plotësuara. Po ashtu kemi vërejtur se bllokat nuk dorëzohen me kohë.</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që dëftesat të plotësohen sipas rregulloreve dhe bllokat të dorëzohen brenda afateve te parapara kohore..</p>	I implementuar
6	<p>Në kontratën e nënshkruar me datën 17.04.2006 për furnizim me material ushqimor dhe higjienë, pjesa e II më vlerë prej 4€ çmimi për njësi kemi vërejtur disa parregullsi siçjanë: - Kompania fituese ka ofruar çmim vetëm për njërin artikull të pjesës së dytë e jo për dy artikujt siç është kërkuar në specifikacion, operatorët tjerë kanë ofruar çmim për dy artikujt mirëpo nuk kanë fituar tenderin, - Vazhdimi i kontratës si aneks është bërë me datën 18.04.2007 edhe per njëvit.</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që të aplikohet neni 57.3 ILPP 2003/17 qe autoriteti kontraktues te vlerësojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tendet në fjale është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit.</p>	I implementuar
6.2	<p>Në kontratën e nënshkruar me datën 26.04.2006 për Riparim dhe mirëmbajtje të automjeteve zyrtare në vlerë prej 17,711€për njësi kemi vërejtur këto parregullsi siç janë: Në kontrate nuk është specifikuar vlera totale e kontratës. Sigurimi i ofertës dhe ekzekutimit nuk është kërkuar. Kërkesa është e panënshkruar nga drejtori për buxhet dhe financa. Faturat janë të panënshkruara nga personi i</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon Komunën që të aplikoj nenin 60.2 dhe 60.4 te LPP 2003/17 per sigurimin e ekzekutimit. Të specifikohet vlera totale e kontratës Faturat të plotësohen qartë në emër të kujt janë lëshuar dhe të nënshkruhen nga personi i cili bënë pranimin.</p>	I implementuar

Auditimi Financiar
Komuna e Gjakovës për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2007

	<p>cili e ka bërë pranimin. Fatura nr. 029404 e datës 13.03.2006 në vlerë 2,225 nuk dihet se per cilin automjet është bërë pagesa.</p>		
6.3	<p>Në kontratën e nënshkruar me datën 01.07.2006 për furnizim vjetor me derivate të naftës çmimi për njësi është 6.31€kemi vërejtur parregullsitë siç janë: - Nuk është specifikuar vlera totale në kontratë. - Në kontratë nuk ka qenë i parapare ndryshimi i çmimit të derivateve sipas lëvizjes së çmimit të berëzës. - Kërkesapërblerje (shpenzimet për derivate) është e panënshkruar nga Krye-shefi dhe drejtori per Buxhet e financa -Regjistri i operatorëve ekonomikë që kanë pranuar dosjen e tenderit është i panënshkruar nga zyrtari i prokurimit.</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që në kontrata të specifikohet vlera totale e kontratës dhe të zbatohen kushtet e parapatë kontratës</p>	I implementuar
6.4	<p>Në kontratën e nënshkruar me datën 28.07.2006 për furnizim me dru për ngrohje dhe sharritjen e tyre në vlerë totale prej 48,251€(çmimi per meter 33.30€). Autorizimi per CPO nr. 46650 në vlerë 1,332€nuk ka qenë korrekt (nuk është ofruar dëshmi së personi i cili ka bërë autorizimin e ka pasur nënshkrimin e deponuar në thesar). - Aneks kontrata është nënshkruar më datën 01.09.2006 në vlerë 3,663€</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që personat që bëjnë autorizimin e shpenzimeve të kanë të deponuar nënshkrim në thesar si autorizues.</p>	I implementuar
6.5	<p>Në Kontratën e nënshkruar me datën 22.08.2006 për ndërtimin e qendrës familjare në Dardani - Piskote në vlerë 69,827€ndërsa aneksi është nënshkruar me datën 27.11.2006 në vlerë 6,952€kemi vërejtur parregullsitë siç janë: - Fillimi i procedurave të prokurimit pa siguruar lejen e ndërtimit, - Nuk na janë prezantuar dëshmi bindëse se ka qenë i arsyeshëm ri-tenderimi. -Per vonesa në kryerjen e punëve nuk na është afruar ndonjë arsyetim dhe nuk janë aplikuar penalet, përkundër kësaj është nënshkruar aneks kontrata.</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që Komuna per ndertime te siguroje me kohe lejet e ndertimit si dhe të aplikimin penaleve per vonesa në punë.</p>	I implementuar
6.6	<p>Kontrata e nënshkruar me datën 14.08.2006 për rekonstruim - asfaltimin e rrugëve Luigj Gurakuqi dhe Mihal</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që të te aplikohen penalet per vonesat e mbarimit te puneve.</p>	I implementuar

Auditimi Financiar
Komuna e Gjakovës për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2007

	<p>Grameno në vlerë 67,919€ndërsa aneks kontrata është nënshkruar në vlerë 4,199€ me datën 27.11.2006 kemi vërejtur parregullsitë siçjanë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Punët nuk janë kryer sipas planit dinamik dhe nuk na është ofruar dëshmi se ka pas ndonjë arsye per vonesa në kryerjen e punëve. - Per te cilat vonesa nuk jane aplikuar penalet. -Sipas faturës së dates 05.12.2006 në vlerë prej 4,199€ është bërë pagesa e aneks kontratës ku punët e aneksit janë kryer para së të kryhen punët e kontratës baze (punët e kontratës janë kryer me datën 19.12.2006 në faturën pa numër në vlerë 13,549€pas përfundimit të aneksit. 		
6.7	<p>Në kontratën e nënshkruar me datën 04.12.2006 për asfaltimin e rrugës në fshatin Fierzë në vlerë prej 219,219€ kemi vërejtur këtoparregullsitësiçjanë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kërkesa për aprovim të shkurtimeve për afat kohor është bërë për vlerën 110,000€ ndërsa kontrata është nënshkruar në vlerë prej 219,219€ - Punët nuk janë kryer sipas kohës se paraparë në kontratë dhe sipas specifikacioni,(nuk është shtruar trashësia asfaltit sipas kontratës). - Nuk është ofruar ndonjë dokument (dëshmi si do të kryhen punët deri në vlerën totale të kontratës). - Zotimi është bërë vetëm për vlerën 30,000€ - Autorizimet në CPO jo korrekte. - Personi i njëjtë në dy komisione të vlerësimit dhe të organit mbikëqyrës. - Sigurimi i tenderit nuk është bërë në vlerën totale të kontratës por është bërë vetëm për vlerën e zotimit të mjeteve. - Garancioni bankar nuk ka date. 	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që të aplikohen vlera e kërkesës per aprovim të shkurtimeve të afatit kohorë.</p> <p>Të zbatohen kushtet e kontratës dhe të specifikohet qartë si do të realizohet deri në vlerën totale. Të aplikohet neni 8 i LPP 2003/17.</p> <ul style="list-style-type: none"> -Autorizimin në CPO ta bëjnë personat që kanë të deponuar nënshkrimin ne thesar si autorizues. -Personat e njëjtë të mos janë në dy komisione. -Të aplikohet neni 60.2 i LPP 20003/17 që autoriteti kontraktues të siguroje që shuma e sigurimit të ekzekutimit të jetë më së paku 10% e vlerës sëkontratës. -Garancioni bankar të këtë datë. 	I implementuar
6.8	<p>Në Kontratën e nënshkruar me datën 25.08.2006 për punimin e planit rregullues në mes të rrugëve "Sadik Stavileci" dhe "UÇK" në vlerë 23,287€e cila përmban edhe aneks kontratë në vlerë 1,700€kemi hasur vërejtjet siçjanë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Personi i njëjtë në dy komisione në të vlerësimit dhe të organit mbikëqyrës. -Mungon kërkesa per sigurim të 	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që personat e njëjtë të mos janë në dy komisione (te vlerësimit dhe organit mbikëqyrës).</p> <ul style="list-style-type: none"> -Të aplikohet neni 60 i LPP 2003/17 per sigurinë e ekzekutimit të kontratës. 	I implementuar

Auditimi Financiar
Komuna e Gjakovës për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2007

	ekzekutimit të kontratës.		
6.9	<p>Në kontratën e nënshkruar me datën 11.07.2006 për punimin e planit rregullues urban në rr. "Tirana"-transit në Gjakovë në vlerë prej 24,750€ dhe aneksi i nënshkruar me datën 27.11.2006 në vlerë prej 2,475€ kemi vërejtur këto parregullsi :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nuk janë kryer punët sipas afatit të parapare në kontratë. -Nuk janë aplikuar penalët (ka pasur vonesa tre muaj për kryerjen e punëve). 	ZRGJ-ja Rekomandon që të aplikohen penalet për vonesa në punë.	I pa implementuar
6.10	<p>Në kontratën e nënshkruar me datën 11.12.2006 për "Furnizim me shtylla dhe tel për ngritjen e pemishteve intensive në Gjakovë" kemi vërejtur se dy prej anëtareve të komisionit të vlerësimit janë edhe anëtare të organit mbikëqyrës.</p>	ZRGJ-ja Rekomandon që personat në komision të vlerësimit të janë të ndryshëm nga personat e organit mbikëqyrës	I pa implementuar
6.11	<p>Në kontratën e nënshkruar me datën 04.04.2005 e cila vlen deri me 04.04.2006 për Furnizim me fidanë të druve Dekorues dhe lule për nevojat e Kuvendit Komunal Gjakovë. Kemi vërejtur këto parregullsi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sipas komisionit të vlerësimit nuk kanë qenë tri oferta të përgj egj shme, - Në aneks kontratën e nënshkruar me datën 05.04.2006 nuk është specifikuar vlera e aneks kontratës prandaj nuk është e qartë sa do të kushtojë aneks kontrata. 	ZRGJ-ja Rekomandon që të aplikohet neni 33.8 i LPP 2003/17 nëse janë pranuar me pak së tre tender të përgjegjshëm autoriteti kontraktues të anulohet aktivitetin e prokurimit, me ç'rast nëse autoriteti kontraktues dëshiron që të prokurojë lenDET përkatëse duhet të fillojë një aktivitet të ri të prokurimit për lenDET e tilla. - Në aneks kontrata të specifikohet vlerat e aneksit.	I implementuar
6.12	<p>Në kontratën e nënshkruar me datën 15.12.2006 për furnizim me uniforma për brigadën e zjarrfikësve Kemi vërejtur këto parregullsi: -Nuk na është ofruar asnjë dëshmi e komisionit të vlerësimit për anulim të tenderit gjithashtu kemi vërejtur se edhe gjatë ritenderimit ka pasur parregullsi siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kriteri i çmimit me të ulet nuk është aplikuar . <p>Firma e cila ka ofruar çmimin në vlerë 10,960€ qe sipas komisionit të vlerësimit e kishte dokumentacionin e kompletuar dhe llogaritjet e sakta e cila edhe pse ka ofruar çmimin me të ulet nuk është shpërblyer. Por është shpërblyer firma qe ka ofruar çmimin në vlerë prej 19,485 e cila ishte me e shtrenjte se dyfirmatjera. -Zotimi i mjeteve është bërë pas</p>	ZRGJ-ja Rekomandon që arsyeja (dokumenti i vlerësimit të komisionit) për eliminim të tenderit tu prezantohet auditorëve dhe mos të bëhen anulime për derisa nuk kanë dëshmi për anulime. -Të aplikohet kriteri i çmimit me të ulët i kërkuar në specifikacion (Neni 50 i LPP 2003/17). -Zotimi i mjeteve të bëhet para nënshkrimit të kontratës.	I implementuar

Auditimi Financiar
Komuna e Gjakovës për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2007

	nënshkimit të kontratës.		
6.13	<p>Në kontratën e nënshkruar me datën 11.11.2006 në vlerë totale prej 601,534€ per ndërtimin e bibliotekës regjionale në Gjakovë.</p> <p>Kemi vërejtur disa parregullsi siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mjetet janë zotuar pjesërisht vetëm deri në vlerën 194,770€e jo per tërë vlerën e kontratës. - Nuk ka dëshmi per sigurimin e ekzekutimit në vlerën prej 10% siç është kërkuar në kriteret e përcaktuara. -Nuk ka dëshmi se kush do ti paguaje pjesën e obligimeve qe dalin nga kontrata mbi vlerën 194,770€ ndërsa në kontratë është parapare afati i përfundimit të punëve per 5 muaj i cili nuk është zbatuar. - Nuk kanë ofruar dëshmi për personin i cili ka nënshkruar si autorizues në CPO me nr. 60518, se e ka nënshkrimin e deponuar në thesar si autorizues. 	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që të aplikohet neni 8.2 i LPP 2003/17 ku fondet per prokurimin përkatës duhet te jene te zotuar ne shumen e mjaftueshme per përmbushjen e detyrimeve qe dalin nga kontrata.</p> <p>-Të aplikohet neni 60 i LPP 2003/17 per sigurimin e ekzekutimit të kontratës.</p> <p>-Në CPO të nënshkruajnë vetëm, personat e autorizuar, ose autorizuesit alternativ.</p>	I pa implementuar
6.14	<p>Prokurimet me vlera minimale</p> <p>Shpenzimet per vlera minimale sipas raportit vjetor kanë qenë në vlerë prej 14,224€ Nga 40 kontrata kemi zgjedhur 6 mostra në vlerë 1,271€respektivisht 15% e vlerës totale per prokurimet me vlera minimale. Në 3 prej 6 mostrave të ekzaminuar kemi vërejtur parregullsitë siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Në kontratën nr. 06/6 per Riparimin e pompës në Gjinnazin "Hajdar Dushi" e nënshkruar me daten 08.03.2006 në vlerë prej 458€ per këtë kontratë mungon data per pranimin e punëve të kryera. - Në kontratën nr. 10/06 per blerjen e printerit të nënshkruar me daten 16.03.2006. <p>Fatura nr. 24 në vlerë prej 460€ është e panenshkuar nga pranuesi i mallit.</p> <ul style="list-style-type: none"> -Në kontratën nr. 28/06 per furnizim me kompjuter e dates 07.08.2006. Fatura Nr. 49 në vlerë prej 400€është e panenshkuar nga personi i cili ka bërë pranimin e fatures. 	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që faturat të janë të nënshkruara nga personat që bëjnë pranimin dhe të mos jenë pa date.</p>	I implementuar
7	Menaxhimi i Pasurisë		
7.1	<p>Gjate auditimit te menaxhimit të pasurive ne komunë kemi gjetur këto parregullsi :</p> <p>Nuk arritëm të sigurojmë dëshmi bindëse se të gjitha pasuritë e blera janë regjistruar.</p>	<p>ZRGJ-jaRekomandon që të zbatohet Instruksioni Administrativ Menaxhimi dhe Regjistrimi i Pasurive</p>	I pa implementuar

Auditimi Financiar
Komuna e Gjakovës për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2007

	<p>-Një pjese e pasurive nuk i kanë të vendosur barkoret.</p> <p>- Nuk është llogaritë zhvlerësimi.</p> <p>-Kemi vërejtur se një pjese e aparaturës nuk funksionon</p> <p>-Ka aparate që nuk janë futur asnjëherë në përdorim (siç është rasti i rëntgenit i cili është blerë në vitin 2004 vlera e të cilit është 102,800€, blerja e rëntgenit është bërë pa kërkesë prej QKMF.</p>	<p>Qeveritare 2005/11 te bëhet</p> <ul style="list-style-type: none"> - Regjistrimi i pasurisë që disponon komuna në sasi dhe vlerë. -Të llogaritet norma e zhvleresimit. -Të mos behen blerje pa kërkesë. -Pajisjet blera duhet të shfrytëzohen per nevojat e parapara ne mënyrë qe te behet shfrytezimi sa me efikasi pajisjeve dhe të arsyetohet investimi. 	
7.2	<p>Shfrytëzimi i veturave</p> <p>Administrata komunale e Gjakovës nuk ka shef të autoparkut.</p> <p>-Sipas shënimeve të cilat na janë ofruar, kemi vërejtur se komuna ka lejuar furnizime me karburante per vetura private te cilat kane qene te shpeshta. Numri i veturave qe jane furnizuar me derivate është 140, per te cilat nuk janë arsyetuar kilometrat e kaluara per qëllimin e udhëtimit.</p> <p>-Shpenzimet per derivate te veturave private kanë qenë 23,428 ndersa shpenzimet per furnizime të veturave zyrtare kanë qenë 21,779.</p> <p>-Një një numër i veturave të komunës nuk janë në gjendje të rregullt.</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që furnizimi me derivate të bëhet vetëm per vetura zyrtare.</p> <p>Të caktohet personi përgjegjës per shef të autoparkut i cili do te menaxhonte përdorimin e automjeteve.</p>	I implementuar
8	<p>Shpenzimet tjera</p> <p>Shpenzimet e parasë së gatshme per vitin 2006 kanë qenë 18,936€</p> <p>Ne kemi ekzaminuar 56 mostra në vlere prej 3,528€apo 19% e vlerës është ekzaminuar, prej tyre 40 mostra janë marre ne administratën komunale vlera e shpenzuar ka qenë 15,000€prej tyre 29% janë shpenzuar per dreka zyrtare. Vlera e ekzaminuar e mostrave ka qenë 2,497€ respektivisht 17%.</p> <p>Në shëndetësi kemi ekzaminuar 16 mostra, Shpenzimet e parasë së gatshme në shëndetësi kanë qenë 3,936€ndersa vlera e ekzaminuar ka qenë 1,028€ respektivisht 26%. Per shpenzimin e parësë së gatshme kemi vërejtur këtoparregullsi:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Fatura e dates 20.11.2006 në vlere prej 31€është e panëshkruar. -Fatura e dates 08.11.2006 në vlerë 60€ per blerje te gomave reglazh per vetura. -Fatura e dates 24.10.2006 në vlerë 40€per blerje të kartelave per telefona. 	<p>Rekomandojmë që të aplikohet rregulla financiare dhe udhëzimet e thesarit - 02 Shpenzimi i parave publike per shpenzimin e parave të imeta.</p> <p>Gjithashtu rekomandojmë komunën qe te ngrit kontrollin e brendshem per shpenzimin e parasë se imet duke mos lejuar;</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpenzime te cilat mund te behen permes procesit normal. -Blerjet pa kërkesë - Ndarje të faturave ne pjese. - Blerje të druve dhe furnizim me derivate nga parja e gatshme deri sa ekziston kontrata per to. 	I implementuar

	<p>-Kërkesa e dates 30.01.2006 është pa numër është nënshkruar per furnizim me derivate në Ohër, ndërsa furnizimi është bërë në Gjakovë me datën 11.01.2006 në vlerë prej 26€</p> <p>-Kërkesa e dates 14.02.2005 në vlerë prej 10 euro per mbushje telefoni është pa numër.</p> <p>-Kërkesa e dates 20.11.2006 ne vlere 31€ është pa numër dhe e panëshkruar.</p> <p>Ne gjithashtu kemi vërejtur se nga paraja e gatshme janë bere furnizime me derivate dhe dru edhe pse ka pas kontratë për furnizim te tyre</p> <p>Gjithashtu kemi vërejtur se per shpenzime te parasë se gatshme ka pasur ndarje të faturave në dy pjesë.</p>		
<p>8.2</p>	<p>Shpenzimet e telefonit</p> <p>Komuna ka një "Udhëzues intern mbi procedurat interne të menaxhimit financiar", i cili ka hyrë në fuqi me 09.03. 2006. Në pikën 9. të udhëzimit përcaktohen çështjet e përdorimit të telefonave në të cilën nuk janë parapare shpenzimet per telefona roming, mirëpo per periudhën para nxjerrjes se këtij udhëzimi nuk na është prezantuar ndonjë rregullore apo udhëzim per shpenzimet e telefonave.</p> <p>Shpenzimet e telefonave kanë tejkuluar limitin e lejuar udhëzuesin e lartpërmendur. Per shpenzimet e telefonisë fikse nga lista e prezantuar gjithsej 49 mostra janë zgjedhe 10 mostra në 8 prej tyre kemi vërejtur se ka pasur tejkalime të limit të shpenzimeve, Shpenzimet e mostrave të zgjedhura per 7 muaj kanë qenë 3,468€vlera e tejkuluar në këto mostra ka qenë 1,477€që është 43% mbi limitin e lejuar te shpenzimeve. . - Shpenzimet e telefonave roming sipas karteles financiare per periudhen 25.01.2006 deri me 19.12.2006 ka qenë 6,472€</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që të aplikohet pika 9 e udhezimit intern mbi procedurat e menaxhimit financiar, të mos tejkalohe limitet e lejuara ne udhezimin intern.</p>	<p>I implementuar</p>

I. FUSHVEPRIMI I AUDITIMIT

ZAGJ ka udhëhequr auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Gjakovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007. Komuna punon nën rregulloren e vetëqeverisjes së Komunave në Kosovë 2000/45, rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/54,2007/30 dhe statutin e Komunës.

Qëllimi kryesor i auditimit është që t'ia mundësojë ZAGJ dhënien e mendimit nëse pasqyrat financiare të Komunës, të paraqitura në Shtojcën I, japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë vitit të përfunduar më 31 Dhjetor 2007, si dhe në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Komtabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) mbi “ Raportimin Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) është përgjegjës për nxjerrjen e SNKSP. Saktësia dhe plotësia e pasqyrave financiare dhe shënimeve përcjellëse në Shtojcën I janë përgjegjësi e menaxhmentit të Komunës.

Auditimi ynë i pasqyrave financiare të Komunës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007 është bërë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) të nxjerra nga Bordi Ndërkombëtar mbi Standardet e Auditimit dhe Sigurimit. Bordi funksionon si organ për vendosjen e standardeve ndërkombëtare nën rrethanat e FNK. SNK themelojnë kornizën ndërkombëtare brenda të cilës ZAGJ performon punën e saj dhe mbulon çështjet si parimet dhe përgjegjësitë e përgjithshme, vlersimet e rrezikut dhe përgjigjet në rreziqet e vlersuara, dëshmitë e auditimit, mbështetja në punët e tjerve, dhe konkluzionet e auditimit dhe raportimi.

V. MENDIMI I AUDITORIT

Bazat për mohimin e dhënies së mendimit

Përmbledhja e çështjeve të rëndësishme të identifikuara përgjatë procedurave tona të auditimit që na shpion deri te mohimi i dhënies së mendimit tonë të auditorit janë paraqitur më tej në këtë pjesë. Të gjeturat dhe rekomandimet tona janë shqyrtuar në detaje në Pjesën VII: Të gjeturat kyqe të auditimit dhe rekomandimet.

A. Procesi i kontabilitetit dhe raportimit financiar

1. Pasqyrat financiare të Komunës të paraqitura në Shtojcën I të këtij raporti janë të mangëta dhe si të tilla jo në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Prandaj ne nuk ishim në gjendje të arrijmë siguri të arsyeshme mbi përshtatshmërinë e informatave financiare të paraqitura ne pasqyrave financiare të komunave për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007.

2. Menaxhmenti i Komunës nuk ka kryer barazim sistematik të të hyrave ndërmjet të dhënave të nxjerra nga burime të ndryshme siq janë në departamentet e komunës dhe/ose departament te Thesarit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe atyre të shpalosura në pasqyrat financiare. Prandaj, ne nuk ishim në gjendje të arrijmë siguri të arsyeshme mbi plotësinë dhe saktësinë e të hyrave të komunës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007.

3. Komuna ka regjistër të mangët të aseteve fikse. Gjatë ekzaminimit tonë ne identifikuan se komuna mirëmban vetëm të dhëna për asetet e blera të vitit 2002. Gjithashtu komuna nuk ka kryer llogaritjen e zhvlersimit në asetet fikse. Për më tepër ne gjetëm se komuna kryen verifikim vjetor të egzistencës fizike të aseteve më 31 Dhjetor por nuk është bërë barazimi i librave të komunës me numërimin fizik. Prandaj, ne nuk ishim në gjendje të sigurojmë vetveten mbi plotësinë dhe saktësinë e regjistrimeve të komunës në lidhje me asetet fikse.

B. Plani dhe efektiviteti operativ i kontroleve të brendshme

4. Duke u bazuar në vlersimin e planit dhe implementimit të disa procedurave, veqanërisht atyre në lidhje me aktivitetet e prokurimit ne gjetëm se komuna ka dështuar në zhvillimin dhe implementimin e procedurave adekuate të autorizimit. Për shkak të mungesës së dëshmime burimore të autorizimit ne nuk ishim në gjendje të sigurojmë vetveten mbi vlefshmërinë e prokurimit të druve për djegie për shkolla që është bërë në Departamentin e Arsimit.

5. Për më tepër duke u bazuar në procedurat tona ne gjetëm se Komuna ka dështuar të vendosë procedura efektive në departamentin e prokurimit në lidhje me menaxhimin e kontratave të furnizimit, pastaj pagesave ndaj furnizuesve dhe mbajtjen e shënimeve për detyrimet e pashlyera ndaj furnizuesve. Siq është shpalosur më detajisht në pjesën VII, për shkak të mosegzistimit të procedurave të tilla, ka rrezik që të paguhet më shumë apo të dështohet në shlyerjen e detyrimeve të kontraktuara.

C. Pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret

6. Rastet në vazhdim të mospajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi,

të cilat janë shtjelluar në tërësi në pjesën VII: Të gjeturat kyqe të auditimit dhe rekomandimet, janë konsideruar të jenë të një rëndësie të veçantë:

- dështimi në kërkimin dhe inkasimin e gjobave në rastet e shmangieve apo vonesave të furnizuesve për të shlyer obligimet e tyre kontraktuese; dhe
- përmbushja e procedurave kontraktuese pas kryerjes së prokurimit.

Mohimi i mendimit

Për shkak të egzistencës së pasigurive të shumta materiale dhe për shkak të rëndësisë së çështjeve të shqyrtuara në paragrafët paraprakë, ne nuk ishim në gjendje dhe nuk shprehim mendim mbi pasqyrat financiare të Komunës në pajtueshmëri me SNKSP “Raportimi Financiar nën Bazën e Kontabilitetit të Parasë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007.

VI. ÇASJA E AUDITIMIT

Auditimi ynë i pasqyrave financiare të Komunës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2007, është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) të lëshuara nga Bordi mbi Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (BSNAS). Bordi funksionon si një organ përcaktues i standardeve ndërkombëtare nën patronazhin e FNK. SNA vendosin kornizën punuese ndërkombëtare përbrenda së cilës ZAGJ kryen punën e saj dhe mbulon çështjet siq janë parimet dhe përgjegjësitë e përgjithshme, vlersimi i rreziqeve dhe përgjigjet ndaj rreziqeve të vlersuara, dëshmia e auditimit, mbështetja në punën e të tjerëve, si dhe konkluzionet dhe raportimet e auditimit.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisive tona ne:

- Kemi rishikuar pasqyrat financiare të Komunës në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2007;
- Kemi përcaktuar nëse pasqyrat financiare të Komunës janë përgatitur në pajtueshmëri me SNKSP-të “Raportimi financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së gatshme”;
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të zgjedhjes së mostrave sipas gjykimit dhe rastit, në zgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;

Të gjetura dhe konkluzionet tona të auditimit bazohen në dokumentacionin, informatat dhe shpjegimet të cilat na janë dhënë gjatë punës sonë të auditimit. Ka të ngjarë që informata shtesë mund të kenë egzistuar, të cilat nuk na janë ofruar neve, dhe po të na ishin ofruar, mund të kishin ndryshuar të gjeturat.

Për sa i përket mendimit të auditorit të ZAGJ lidhur me pasqyrat financiare të Komunës, SNA definojnë kriteret specifike që përcaktojnë llojin e opinionit që mund të ipet. Mendimi i auditimit mund të jetë i pakualifikuar, i kualifikuar, i kundërt ose mund të jetë edhe mohim i mendimit. Për shembull, ZAGJ mund të mos jetë në gjendje të japë një mendim të pakualifikuar kur egziston cilado nga rrethanat vijuese dhe sipas gjykimit të ZAGJ efekti i çështjeve është ose mund të jetë material për pasqyrat financiare:

(a) Kur ka kufizim të fushëveprimit të punës së auditorit; ose

(b) Kur ka mosmarrëveshje me menaxhmentin lidhur me pranueshmërinë e politikave të zgjedhura kontabël, metodën e aplikimit të tyre ose përshtatshmërinë e shpalosjeve të pasqyrave financiare.

Rrethanat e përshkruara në (a) mund të shpiejnë në mendimin e kualifikuar ose në mohimin e mendimit. Rrethanat e përshkruara nën (b) mund të shpiejnë në mendimin e kualifikuar ose në mendim të kundërt.

Një mendim i kualifikuar në përgjithësi shprehet kur ZAGJ konstaton se nuk mund të ipet një mendim i pakualifikuar, porse efekti i ndonjë mosmarrëveshje me menaxhmentin, ose kufizimi i fushëveprimit nuk është material dhe i përhapur sa të kërkojë dhënien e një mendimi të kundërt ose mohim të mendimit.

Mohimi i mendimit do të jepet atëherë kur efekti i mundshëm i kufizimit në fushëveprim është aq material dhe i përhapur sa që ZAGJ nuk ka mundur të siguroj dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse të auditimit dhe rrjedhimish nuk mund të shpreh një mendim lidhur me pasqyrat financiare.

Një mendim i kundërt do të ipet kur efekti i mosmarrëveshjes është aq material dhe i përhapur në pasqyrat financiare për çka dhe ZAGJ konstaton se kualifikimi i raportit nuk është i përshtatshëm për të shpalosur natyrën e çorientuar dhe jo të plotë të pasqyrave financiare.

VII. TË GJETURAT DHE REKOMANDIMET KYQE TË AUDITIMIT

Në vazhdim janë të gjeturat kyqe të auditimit dhe rekomandimet që kanë rezultuar nga auditimi ynë i pasqyrave financiare të Komunës. Komentet e menaxhmentit në lidhje me secilën të gjetur dhe rekomandim janë në vazhdim të secilës pjesë së bashku me vlersimin tonë të komenteve të menaxhmentit. Komentet e menaxhmentit do të përfshihen në tërësi në Shtojcën 2.

A. Procesi i kontabilitetit dhe raportimit financiar

Të gjeturat # 1

Pasqyrat Financiare të Komunës që janë paraqitur në Shtojcën I të këtij raporti janë të mangëta në terme të formës dhe përmbajtjes së tyre siq është përshkruar nga dispozitat relevante të vendosura nga autoritetet dhe si të tilla ato nuk janë në pajtueshmëri me kërkesat e Nenit 41: Raportimi final mbi buxhetin nga Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 2003/2, ku përshkruhet saktësisht formati dhe përmbajtja e pasqyrave financiare të Komunave.

Rekomandimi

Ne i rekomandojmë Menaxhmentit të komunës që të implementojë tërësisht dispozitën përkatëse për sa i përket përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore.

Të gjeturat # 2

Komuna ka raportuar në pasqyrat financiare vjetore të hyrat e tatimit në pronë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007 në vlerë 451,670 Euro, përderisa sipas të dhënave nga departamenti i tatimit në pronë, të hyrat nga tatimi në pronë janë 456,548 Euro.

Rekomandimi

Departamentet e komunës duhet që së paku në baza mujore të barazojnë të dhënat e tyre me ato të regjistruara në departamentin e kontabilitetit. Kjo do të reduktojë gabimet dhe ndryshimet.

Të gjeturat # 3

Duke u bazuar në procedurat e kryera të auditimit ne identifikuar se të dhënat e të hyrave siq janë shpalosur në pasqyrat financiare të komunës dhe atyre të marra nga departamenti i thesarit i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave nuk janë barazuar. Gjithsej ndryshimi prej 312,941 Euro përbëhet nga ndryshimet ndërmjet të dhënave të të hyrave të llogaritura në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe të raportuara për sa u përket gjobave të trafikut për 161,910 Euro, pastaj gjobave të gjykatës për 150,526 Euro dhe agjensisë pyjore për 505 Euro.

Rekomandimi

Menaxhmenti duhet të kryejë barazim sistematik, të paktën në vit të të dhënave me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Të gjeturat # 4

Komuna ka regjistër të mangët të aseteve fikse. Gjatë ekzaminimit tonë ne kemi identifikuar se komuna mban të dhëna vetëm për asetet e blera nga viti 2002. Veç kësaj llogaritja e zhvlersimit mbi asetet fikse nuk është kryer.

Për më tepër kemi gjetur se komuna kryen verifikim vjetor të egzistencës fizike të aseteve më 31 Dhjetor por nuk është bërë barazimi i librave të komunës me rezultatet e numërimit fizik.

Rekomandimi

Ne i rekomandojmë Komunës në mënyrë që të mund të ofrojë mbrojtje adekuate të aseteve të saj të mbajë shënime dhe dokumentacion për të gjitha asetet dhe së paku në vit të kryejë barazim sistematik të librave të saj me rezultatet e numërimit fizik.

B. Dizajni dhe efektiviteti operativ i kontrolleve të brendshme

Të gjeturat # 5

Nga inspektimi i dokumenteve burimore gjegjëse për prokurimin e drurit për djegie të bërë nga departamenti i arsimit për dy shkolla në shumën 1,020 Euro ne nuk gjetëm ndonjë dëshmi se personat përgjegjës kanë zbatuar procedurat e duhura të autorizimit që do të vërtetonin vlefshmërinë dhe plotësinë e prokurimit. Ne nuk arritëm të identifikonim personin që ka nënshkruar si pranues dhe fletëdërgesa nuk është vulosur nga institucioni pranues (shkolla).

Rekomandimi

Ne i rekomandojmë menaxhmentit që saktësisht të implementojë autorizimin e të gjitha dokumenteve burimore në lidhje me transaksionet e prokurimit duke caktuar personat e duhur përgjegjës.

Veç kësaj, komuna duhet të sigurojë që procedura të mjaftueshme monitoruese po implementohen për sa u përket sasive dhe cilësisë së furnizimeve të bëra.

Të gjeturat # 6

Gjatë inspektimit tonë të dokumenteve burimore në departamentin e prokurimit ne gjetëm se nënpunësi i prokurimit nuk mund të na ofronte informata të sakta, të azhurnuara mbi detajet e kontraktorëve të prokurimit, pagesat që u janë bërë atyre si dhe detajet e detyrimeve të pashlyera nga furnitori.

Rekomandimi

Nënpunësi i prokurimit duhet të mbajë të dhëna të mjaftueshme dhe të detajuara për prokurimet e kontraktuara, faturat e pranuar dhe të paguara gjatë vitit si dhe shumat e detyrimeve të pashlyera për secilin furnitor. Kjo do të zvogëlonte rrezikun e pagesave të dyfishta ose dështimin në shlyerjen e detyrimeve të kontraktuara.

C. Pajtueshmëria me ligjet dhe rregulloret

Të gjeturat # 7

Duke u bazuar në ekzaminimin tonë mbi implementimin e disa afateve dhe kushteve kontraktuese të prokurimit, ne gjetëm dy raste siq janë treguar më poshtë, ku organet autorizuese të komunës kanë dështuar në kërkimin dhe inkasimin e gjobave për shkak të vonesave të furnizuesve në shlyerjen e obligimeve të tyre, siq janë:

- Punet ndërtimore në shollën fillore “Selman Riza”
- Ndërtimi i çatisë dhe sallës së madhe të kuvendit komunal

Rekomandim

Ne i rekomandojmë Komunës që saktësisht të implementojë afatet dhe kushtet kontraktuese për sa i përket kërkimit dhe inkasimit të gjobave për shkak të dështimeve të furnitorëve.

Të gjeturat # 8

Nga inpektimi i dokumentacionit burimor në lidhje me kontratën për përforcimin e shëndetit primar në QKMF Gjakova ne gjetëm se kontrata është nënshkruar më 18 Dhjetor 2007; ndërsa prokurimi dhe faturimi janë kryer p.sh. janë kompletuar më herët gjatë Tetorit 2007.

Rekomandim

Ne i rekomandojmë fuqishëm komunës që të ndjekë dispozitën e LPP 2003/17, ashtu që zotimi duhet të bëhet përpara fillimit të procedurave të prokurimit.

Shtojcë I

Komuna e Gjakovës

Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më
31 Dhjetor 2007

Nr. i të gjeturës	Komentet e Menaxhmentit të Komunës	Komentet e Auditorit
1	<p>Lidhur me rekomandimin tuaj të dhëna në këtë pikë më duhet të ju njoftoj se pasqyrat financiare (tabelat) përgatiten nga ana e Ministrisë dhe Ekonomisë dhe Financave (MEF-i) ndërsa ne ato tabela vetëm i plotësojmë me vlera.</p> <p>Andaj këtë nuk mund ta konsiderojmë shkelje pasi që këto tabela janë formate të përgatitura nga MEF-I dhe vlejné për të gjitha komunat e Kosovës.</p>	Rekomandimi për komunën lidhur më këtë të gjetur mbetet
2	<p>Sa i përket rekomandimit tuaj të dhëna në këtë pikë, ne kostatojmë se vlera e saktë e të hyrave nga tatimi në pronë është 451,670 Euro dhe kjo vlerë është e barazuar edhe me thesarin, ndërsa vlera e prezantuar në shumë prej 456,548 Euro, nuk qëndron.</p>	Rekomandimi për komunën lidhur më këtë të gjetur mbetet.
3	<p>Të hyrat komunale janë barazuar me thesar ku ekziston edhe dokumenti i nënshkruar nga dy palët MEF-I dhe Komuna. Tabelat financiare të marruara nga ana juaj në komunë me rastin e auditimit prezantojnë edhe shkoqitjen e vlerës prej 312.941Euro të hyra komunale të realizuara jashtë llogarisë komunale si: gjoba në trafik 161.910 Euro; gjoba nga gjykata 150,526 Euro; dhe gjobat nga agjencioni pyjor 505,32 Euro.</p>	Rekomandimi për komunën lidhur më këtë të gjetur mbetet.
4	<p>Komuna mban të dhëna të asetëve të blear nga viti 1999, ndërsa për asetet para vitit 1999 janë të regjistruara dhe evedentuar nga komisioni I regjistrimit të asetëve. Ndërsa zhvlerësimi I vlerës së asetëve (amortizimi) është kompetencë e MEF-it dhe akoma si Kuvende Komunale nuk kemi marruar rekomandime për futjen në sistem amortizimin e asetëve edhe pse programi është i gatshëm vetëm pritet rekomandimi i MEF-it. Cdo vit komuna e bën barazimin e asetëve në vlerë dhe në sasi dhe në të gjitha asetet janë të vendosur numrat identifikues.</p>	Rekomandimi për komunën lidhur më këtë të gjetur mbetet.
5	<p>Lidhur me këtë pikë duhet të theksojmë se furnizimi me lëndë djegëse për dy shkolla në vlerë prej 1,020 Euro, është bërë në bazë të procedurave të prokurimit dhe këtë e dëshmon edhe kontratat e lidhur me datë 26.02.2007, me firmën fituese "Tini" si dhe ekzistojnë edhe fletëdergesat për dërgimin e lëndëve djegëse në këto dy shkolla njëra me datë 27.02.2007 e tjetra me datë 28.02.2007 dhe në të dy fletëdergesat kanë nënshkruar drejtoret e shkollave që e kanë bërë pranimin e lëndëve djegëse vetën se të njëjtat fletëdergesa nuk i kanë vulosur me vulën e shkollës, sepse kemi menduar që kjo nuk është e domosdoshme që në fletëderges të vendoset vula e shkollës.</p>	Rekomandimi për komunën lidhur më këtë të gjetur mbetet.

6	<p>Gjatë vitit 2007, të gjitha pagesat e vërtetuara nme vulën e thesarit janë në drejtorinë për Buxhet e Financa dhe të njëjtat nuk janë dorëzuara në zyrën e prokurimit kjo ka ndodhur si rezultat i ndryshimeve në menaxhment pra ka pasur ndryshime të Drejtorit të kësaj Drejtorie si dhe rezultat i zgjedhjeve të fundit komunale ku që nga muaj tetor 2007 puna është kryer me ushtrues detyre të Drejtorit. Këtë pikë tani e tutje do ta implementojmë dhe gjatë këtij viti të gjitha pagesat gjendet në zyrën e prokurimit.</p>	<p>Komuna pajtohet me të gjeturat dhe rekomandimet e auditorit</p>
7	<p>Lidhur me të gjeturat e prezantuara në pikën e shtatë sqarojmë me sa vijon, punët ndërtimore në shkollën fillore “Selman Riza” janë kryer gjatë zezonës dimërore andaj kushtet klimatike e kanë penguar firmën në përmbushjen e detyrimeve sipas afateve të parapara me kontratë, andaj kjo ka qenë arsyeja e jonë që nuk e kemi ndëshkuar firmën që ka bërë ekzekutimin e punimeve. Vlen të theksojmë se firma që ka bërë ekzekutimin e punimeve në vazhdimësi ka qenë në kontakt me komisionin komunal për mbikqyrjen e punimeve dhe e gjithë puna ka shkuar sipas konsultimeve të përbashkëta.</p> <p>Sa i përket ndëshkimit të firmës që ka bërë ekzekutimin e punimeve të catisë dhe sallës së madhe të Kuvendit të Komunës duhet të sqarojmë se bartëse e projektit ka qenë GTZ-ja ndërsa se si Kuvend i Komunës dhe Minsistria e Administrimit të Pushtetit Lokal kemi qenë bashkë investitor, pra edhe një herë duhet të theksojmë se bartëse e projektit ka qenë GTZ-ja.</p>	<p>Komuna pajtohet me të gjeturat dhe rekomandimet e auditorit</p>
8	<p>Lidhur me këtë pikë duhet të sqarojmë se pas nënshkrimit të kontratës në muajin Dhjetor 2007, të gjitha pagesat bazuar në këtë kontratë janë kryer në vitin 2008. Ndërkaq fatura e vitit 2007, pra para nënshkrimit të kësaj kontrate është paguar si subvencion në bazë të vendimit të Bordit të drejtorve nr 01/163/2007.</p>	<p>Komuna pajtohet me të gjeturat dhe rekomandimet e auditorit</p>

